



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:082853
Datë: 14.05.2024
Numri i dokumentit: 05680325

AA.nr.419/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrativ, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Hajriz Hoti kryetar i kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Delushe Halimi anëtarë, në çështjen e konfliktit administrativ sipas padisë së paditësit, K.B nga Prishtina, të cilin me autorizim e përfaqëson, Kadri Begolli, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës, Komuna e Gjakovës–Drejtoria e Arsimit në Gjakovë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative A.nr.957/2024, të datës;15.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë;13.05.2024 merr këtë,

A K T V E N D I M

Miratohet si e bazuar ankesa e paditësit, K.B, nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative A.nr.957/2024, i datës;15.03.2024, priset, dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative A.nr.957/2024, të datës;15.03.2024, është vendosur, *“REFUZOHET si e pabazuar kërkesa e paditësit/propozuesit K.B, nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nr.01-070/01-1402 të datës 14.02.2024 lëshuar nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit Gjakovë, deri në vendosjen e çështjes sipas padisë.”*

Kundër këtij aktvendimi i autorizuari i paditësit, Kadri Begolli, avokat nga Prishtina, ka ushtruar ankesë, me të cilin konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga nenit 182.1 dhe 182.2 pika n të LPK, vërtetimit të jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike nga neni 183 par 1, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga neni 184 të LPK, me propozim që aktvendimi A.nr.957/2024, të datës;15.03.2024, i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të ndryshohet dhe të lejon masën e sigurisë, ose aktvendimin ta anulohet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar pala e paditur.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të aktvendimit të kundërshtuar në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se, ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtrua padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative, me datë;14.03.2024, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën Komunën e Gjakovës-Drejtorinë e Arsimit që të detyroj personin përgjegjës në shkollës fillore “K...” në Gjakovë të lëshoj çregjistrimin nga kjo shkollë për të miturin B.B, me qëllim që i mituri të vijon mësimin e rregullt në shkollës përkatëse fillore në Prishtinë për vitin shkollor 2023/2024. Gjithashtu ka kërkuar edhe lejimin e masës së përkohshme me të cilin do të detyroj të paditurën Komunën e Gjakovës-Drejtorinë e Arsimit që të detyroj personin përgjegjës në shkollës fillore “K...” në Gjakovë të lëshoj çregjistrimin nga kjo shkollë për të miturin B.B, me qëllim që i mituri të vijon mësimin e rregullt në shkollës përkatëse fillore në Prishtinë për vitin shkollor 2023/2024.

Departamentit për Çështje Administrative, pas shqyrtimit të kërkesës së paditësit të paraqitur kundër të paditurës, jashtë seance bie aktvendimin e ankimuar me të cilin e refuzon si të pa bazuar kërkesën e paditësit, me arsyetim se *“Për të vlerësuar kërkesën e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, gjykata iu referua nenit 22 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) i cili përcakton se: “Me kërkesën e paditësit, organi akti i të cilit ekzekutohet gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t’i sillte dëm paditëses, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, as që shtyrja do t’i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar”.* Ndërsa me paragrafin 6 të të njëjtit nen përcaktohet se: *“Paditësi mund të kërkoj edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni”.* Kjo dispozitë në mënyrë eksplicite përcakton se për shtyrjen e ekzekutimit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dy kushtet e përcaktuara: ekzekutimi t’i sjell dëm paditësit dhe shtyrja të mos jetë në kundërshtim me interesin publik. Duke vlerësuar kërkesën e paditësit, gjykata pas shqyrtimit të dokumenteve të bashkangjitura, ka gjetur se paditësi me asnjë provë nuk e ka bërë të besueshme pretendimin e tij se pezullimi i ekzekutimit të vendimit të cilin e kërkon, nuk është në kundërshtim me interesin publik, kusht ky ligjor për shtyrjen e ekzekutimit, e i cili duhet të provohet nga paditësi. Paditësi me kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit nuk ka dhënë fakte për të mbështetur kërkesën e tij, respektivisht nuk ka ofruar prova për të vërtetuar plotësimin e kushteve të parapara me nenin 22 par.2 të LKA-së. Kërkesa tërësisht është mbështetur në provat dhe faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, për të cilat gjykata do të vendos në mënyrë meritore pas shqyrtimit të kërkesëpadisë, por të cilat nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës për shtyrje të ekzekutimit.”

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, bazuar në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të aktvendimit, e duke i pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, gjen se aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 nën paragrafi n), dhe nga neni 183 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshme sipas nenit 63 të Ligjit për Konflikte Administrative, pasi që i njëjti është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij, dhe si i

tillë është jo i plotë edhe në vërtetimin e gjendjes faktike, dhe në zbatim të gabuar të dispozitave procedurale nga nenit 33 të LKA-së.

Meqenëse aktvendimi i ankimuar përmban të meta të tilla të lartcekura, për shkak të te cilave i njëjti nuk mund të shqyrtohet, ngase arsyet e dhëna në të janë të paqarta, sepse Gjykata pas shqyrtimit të padisë, nuk i ka kushtuar vëmendje të duhur parakushteve, përkatësisht prezumimeve procedurale, të cilat duhet të plotësohen, për vlerësimin fillimisht të rregullsisë së objektit e kërkesëpadisë së paditësit, e që i referohet, detyrimit të paditurës Komunës së Gjakovës-Drejtorinë e Arsimit që të detyroj personin përgjegjës në shkollës fillore “K...” në Gjakovë të lëshoj çregjistrimin nga kjo shkollë për të miturin B.B, me qëllim që i mituri të vijon mësimin e rregullt në shkalës përkatëse fillore në Prishtinë për vitin shkollor 2023/2024.

Pra Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë identifikimin e saktë të natyrës së objektit të kontestit, duke mos bërë kështu përcaktimin e saktë të faktit nëse objekti i kontestit është çështje që mund të iniciohet konflikti administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Me nenin 26 të Ligjit për Konfliktet Administrative, është përcaktuar se “1. Konflikti administrativ fillohet me padi 2. Me padi mund të kërkohet: 2.1. anulimi ose shpallja e pavlefshme e aktit kontestues; 2.2. nxjerrja e aktit administrativ, i cili nuk është nxjerrur në afatin e parashikuar; dhe 2.3. kthimi i sendeve të marrura dhe kompensimi i dëmit i shkaktuar me ekzekutimin e aktit administrativ të kontestuar.”

Kurse neni 33 të Ligjit për Konfliktet Administrative, përcakton se “1. Nëse padia nuk është e plotë, është e pakuptueshme ose ka të meta, kryetari i kolegjit do të ftojë paditësin, që brenda afatit prej tetë (8) ditëve t’i mënjanojë të metat e padisë. Në ftesë duhet të ceken udhëzimet për të mënjeluar të metat e padisë dhe paralajmërimi për pasojat që do të lindin nëse nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës. 2. Nëse paditësi, brenda afatit të cekur, nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do ta hedhë poshtë me vendim padinë, nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm.”

Sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, pasi që në rastin konkret sipas objektit të kërkesëpadisë së paditësit nuk kemi të bëjmë me çështjen juridike anulim të ndonjë vendimi të paditurës, Komuna e Gjakovës, kundër të cilit do të mund të iniciohet konflikti administrativ, në bazë të nenit 13 të Ligjit për Konfliktet Administrative, me të cilin është përcaktuar se “1. Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë. 2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar”. Ndërsa me nenin 14 të LKA-së, përcaktohet se “Konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj”. Gjithashtu me nenin 9 të LKA-së është përcaktuar se “Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.” Ndërsa me nenin 10 par.1 të te njëjtit ligj, është përcaktuar se “Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes ligjor”. Por kemi të bëjmë me detyrimin e të paditurës, Komuna e Gjakovës-Drejtorinë e Arsimit që të detyroj personin përgjegjës në shkollës fillore “K...” në Gjakovë të

lëshoj çregjistrimin nga kjo shkollë për të miturin B.B, me qëllim që i mituri të vijon mësimin e rregullt në shkollës përkatëse fillore në Prishtinë për vitin shkollorë 2023/2024, në këtë kuptim kolegji i apelit vlerëson se për Gjykata e shkallës së parë ka qenë dashtë që padinë paditësit t'ia kthej në plotësim në drejtim të aktit përfundimtar që kontestohet, e i cili akt gjendet në shkresat e lëndës me nr.01-070/01-1402, i datës;14.02.2024, me të cilin e paditura e ka refuzuar ankesën e paditësit si të pa bazuar.

Për arsyet e lartcekura, aktvendimi i kundërshtuar është dashtë të priset dhe çështja t'i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje, për t'i mënjeluar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës të theksuara më lartë, që janë të tilla që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të goditur.

Në ri-procedurë, Gjykata e shkallës së parë duhet ti mënjanoj të metat e vërejtura sipas këtij aktvendimi, e që i referohen rregullsisë së padisë së paditësit, përkatësisht të bëjë kthimin e padisë në plotësim në pajtim me nenin 33 lidhur me nenin 26 të LKA-së dhe pas mënjanimi të kësaj shkelje, Gjykata e shkallës së parë ka mundësi të merr aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm në kuptim të dispozitave të sipërcituara të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 dhe 63 të Ligjit për Konflikte Administrative, lidhur me nenin 208, dhe 209 paragrafi 1 nën paragrafi d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË
AA.nr.419/2024, datë;13.05.2024

Kryetari i kolegjit,
Hajriz Hoti